

RELACION

Mbi

RAPORTIN E MONITORIMI TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR 4 MUJORIN E PARË TË VITIT 2021

Për vitin 2021, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë administron dhe menaxhon fondet buxhetore sipas 12 programeve, si më poshtë:

1. Planifikim, Menaxhim, Administrim
2. Transporti Rrugor
3. Transporti Detar
4. Transporti Hekurudhor
5. Transporti Ajror
6. Furnizimi me Uje dhe Kanalizime
7. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
8. Mbështetje për Energjinë
9. Mbështetje për Burimet Natyrore
10. Mbështetje për Industrinë
11. Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit
12. Planifikimi Urban

Në zbatim të ligjit nr.137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021”, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i janë miratuar 49.875.338 mijë lekë, sipas programeve buxhetore:

	<i>në mijë lekë</i>
Planifikim, Menaxhim, Administrim	506.100
Transporti Rrugor	26.221.055
Transporti Detar	155.000
Transporti Hekurudhor	2.122.000
Transporti Ajror	140.300
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	12.709.511
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	3.714.272
Mbështetje për Energjinë	3.246.000
Mbështetje për Burimet Natyrore	282.000
Mbështetje për Industrinë	406.000
Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	20.000
Planifikimi Urban	303.100

Sqarojmë se buxheti pati ndryshim në zbatim të VKM nr.525, datë 1.7.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të Urës së Tapizës” prej 151.540 mijë lekë dhe si rezultat i alokimit të fondit të veçantë prej 4.500 mijë lekë.

Të dhënat e raportuara (sipas Aneksit nr.1) të buxhetit fillestar dhe realizimi faktik përkojnë plotësisht me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në fund të 4 mujorit të parë të vitit 2021, ka realizuar shpenzimet e buxhetit, krahasuar me planin prej 23%.

Sipas programeve buxhetore, realizimi (në %) paraqitet si më poshtë:

<u>Kod Programi</u>	<u>Programi</u>	<u>Realizimi (në%)</u>
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	25
04520	Transporti Rrugor	26
04540	Transporti Detar	41
04550	Transporti Hekurudhor	7
04560	Transporti Ajror	18
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	19
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	41
04320	Mbështetje për Energjinë	1
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	27
04440	Mbështetje për Industrinë	30
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	-
06180	Planifikimi Urban	2

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, realizimi (në %) kundrejt planit të buxhetit paraqitet si më poshtë:

<u>Kod Programi</u>	<u>Programi</u>	<u>Shpenzime Korrente</u>	<u>Shpenzime Kapitale</u>
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	26	-
04520	Transporti Rrugor	37	25
04540	Transporti Detar	27	71
04550	Transporti Hekurudhor	32	-
04560	Transporti Ajror	14	19
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	4	19
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	85	32
04320	Mbështetje për Energjinë	6	1
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	28	26
04440	Mbështetje për Industrinë	33	22
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	-	-
06180	Planifikimi Urban	27	-

Programi “PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM”

Për 4 mujorin e parë, në Aparatin e Ministrisë janë realizuar 11 projekt-akte ligjore dhe nënligjore nga 12 të planifikuara; janë audituar 6 institucione varësie nga 24 të planifikuara dhe janë kryer 3 pagesa për kuotat ndërkombëtare nga 8 të planifikuara.

Shpenzimet Korrente

- *Paga dhe sigurime*, plani buxhetor i vitit 2021 prej 330.4 milion lekë është realizuar në vlerën 95.5 milion lekë ose 29%.
- *Shpenzime operative*, plani buxhetor i vitit 2021 prej 100 milion lekë është realizuar në vlerën 14.2 milion lekë ose 15%.
- *Transferrat korrente të huaja*, plani buxhetor i vitit 2021 prej 28 milion lekë është realizuar në vlerën 3.8 milion lekë ose 14%, pagesa të cilat janë realizuar për TCT, ICOLD dhe Energy Community.
- *Transferrat për Buxhetin Familjar dhe Individual*, plani buxhetor i vitit 2021 prej 34.6 milion lekë është realizuar në vlerën 12.3 milion lekë ose 36%.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Plani i buxhetit për vitin 2021, për këtë program është në shumën 13 milion lekë.

Sipas projekteve ai është parashikuar për:

- “Blerje pajisje zyre” në vlerën 3 milion lekë;
- “Blerje autoveture” në vlerën 5.4 milion lekë;
- “Instalimi i sistemit të fonisë, projektim, ndriçim në sallën e mbledhjeve” në vlerën 1 milion lekë;
- “Sistemi i sinjalizimit të fonisë, projektim, ndriçimit në sallën e mbledhjeve” në vlerën 1 milion lekë;

Sqarojmë se për këto projekte nuk ka realizim pasi janë planifikuar të prokurohen në 6 mujorin e dytë të vitit 2021.

- Kosto lokale në vlerën 2.6 milion lekë, është propozuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të sistemohet në programin “Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit”.

Programi “TRANSPORTI RRUGOR”

Shpenzimet Korrente

Plani i buxhetit për shpenzime korente (llog.602) për vitin 2021 është në vlerën 1,304,629,000 lekë dhe përbëhet nga 220,000,000 lekë për zërin shpenzime administrative dhe 1,084,629,000 lekë për financimin e kontratave të mirëmbajtjes.

Për 4 mujorin e parë të vitit 2021 janë financiar në vlerën 493,902,003 lekë ose 38% e buxhetit të parashikuar. Konkretisht:

- Shpenzime administrative 47,443,737 lekë ose 22% e buxhetit të planifikuar;
- Mirëmbajtje rrugore 446,458,266 lekë ose 41 % e buxhetit të parashikuar.

Sqarojmë se, deri në 4 mujorin e parë të vitit 2021 janë likuiduar të gjithë detyrimet e prapambetura nga viti 2020. Me buxhetin e fillimit të vitit 2021, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka likuiduar të gjithë detyrimet e prapambetura në vlerën 244,342,922 lekë të detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes ose 100% të detyrimeve. Konkretisht:

- Autoriteti Rrugor Shqiptar Qendër , në vlerën 74,171,272 lekë;
- Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, në vlerën 107,707,919 lekë.
- Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë, në vlerën 62,463,731 lekë.

Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, sipas konfirmimeve të marra nga degët e thesarit u realizuan në masën 2,964,025,982 lekë, ose e shprehur në përqindje 37% e planit të buxhetit të vitit 2021.

Realizimi i detajuar për çdo objekt rrugor, jepet në informacionin përkatës “Mbi realizimin e Investimeve Rrugore” sipas tabelës nr.10 “Projektet me financim të brendshëm” (Aneksat e Monitorimit).

Nga të dhënat e tabelës nr.10 dhe Aneksit të Raportit të Monitorimit, për 4 mujorin e parë të vitit 2021, fondet e planifikuara janë 8,033,359,896 lekë së bashku me fondet e rindërtimit për Urën e Tapizës në vlerën 151,539,896 lekë dhe realizimi për 4 mujorin e parë të vitit 2021 është 2,964,025,982 lekë ose 37% .

Me buxhetin e vitit 2021 në ARRSH u mbështetën me fonde buxhetore të gjithë kontratat në vazhdim dhe u parashikuan fonde buxhetore dhe për hapjen e kontratave të reja.

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2020 në ARRSH ishin në total në vlerën 537,053,932 lekë, ku 292,711,010 lekë për zërin investime (vetëm vendime gjyqësore) dhe 244,342,922 lekë për kontrata e mirëmbajtjes.

Duke qenë se buxheti i vitit 2021 i zërit investime është më i vogël se nevojat që ka ARRSH-ja për fonde buxhetore, me detajimin e buxhetit të vitit 2021, ARRSH-ja parashikoi likuidimin e vetëm 40,000,000 lekë të detyrimeve të zërit Vendime Gjyqësore ose 13.7%.

Detyrimet e mbetura të zërit vendime gjyqësore do të likuidohet gjatë vitit 2021 me rialokime ose në fazën e rishikimit të buxhetit.

Për financimin e kontratave të reja në vitin 2021, ARRSH-ja ka nevoja për fonde buxhetore shtesë, pasi i gjithë buxheti i akorduar për vitin 2021 nga sistema i thesarit është obliguar për kontrata e lidhura dhe kemi vështirësi në rregjistrimin dhe financimin e kontratave të reja që janë lidhur në vitin 2021 dhe ato që do të lidhen në vazhdim të vitit 2021.

Deri në 30.04.2021, në Autoritetin rrugor Shqiptar janë krijuar detyrime të prapambetura (Fatura pa buxhet) në zërin investime në vlerën 1,178,452,156 lekë, si më poshtë:

- Ndërtim dhe Sistemim rrugësh në vlerën 202,598,637 lekë;
- Sinjalistikë dhe siguri rrugore në vlerën 68,636,563 lekë;
- Supervision punimesh në vlerën 1,944,516 lekë;
- Vendime Gjyqësore në vlerën 94,522,370 lekë; (duke I shtuar vlerën e mbetur nga viti 2020 në vlerën 252,711,010 lekë, detyrimi shkon në vlerën 347,233,380 lekë).
- TVSH & Kosto locale në vlerën 910,070 lekë;
- Shpronësime për VKM të dala por të pa likuiduara në vlerën 800,000,000 lekë.
- Përmirësim i dhomës së serverit ARRSH në vlerën 9,840,000 lekë.

Detyrimet e prapambetura totale bashkë me mirëmbajtjen në 4 mujorin e parë të vitit 2021 janë në vlerën 1,467,508,669 lekë.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Nga të dhënat “Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve” rezulton se:

➤ **Ndërtim rruge**

Grupi i produktit “Ndërtim rruge” i shprehur në sasi (km) për 4 mujorin e parë të vitit 2021 është parashikuar 8.22 km dhe është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 5 km dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt është planifikuar 5,062,099,000 lekë dhe është realizuar 2,259,794,000 lekë ose 44.6 % e planit.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1’ me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për 4 mujorin e parë të vitit 2021 konkretisht:

<u>PLANIFIKUAR</u>	<u>FINANCUAR</u>
A2 me standartet e reja - 0.34 km	0.24 km ose 70.6 % e planit.
A e modifikuar - 0.53 km	0.53 km ose 100 % e planit.
A2’ - 1.54 km	1.03 km ose 66.9 % e planit.
B1’ - 1.72 km	0.63 km ose 36.6 % e planit.
C2 - 4.09 km	2.57 km ose 62.8 % e planit.

Për zërin “Ndërtim rruge” janë planifikuar fonde buxhetore për kontratat në vazhdim dhe për kontrata e reja që janë çelur me buxhetin e vitit 2021.

Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge” i shprehur në sasi (km) për 4 mujorin e parë të vitit 2021 nuk ka asnjë objekt të parashikuar për financim.

Më poshtë po rendisim komentet tona mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve për 4-mujorin e parë të vitit 2021:

Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të Reja

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,018,218,000 lekë (20.1 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0.34 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 784,820,000 lekë ose 77% e buxhetit të planifikuar. Përfshihen në këtë grup rruge:

-Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja

Loti 1, Loti 2, Loti 3;

- Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij;

-Studim Projektim mbikalimi TEG;

- Studim-projektim, rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të unazës së madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri.

Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 937,862,000 lekë (18.5 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 1.54 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 325,885,000 lekë ose 34.7 % e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 1.03 km ose 66.9 % e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Përfundim i Punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit;
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 2, Loti 3 ;
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3;
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2.
-

Ndërtim rruge tip B1' me dy korsi

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,752,295,000 lekë (34.6 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 1.72 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 534,256,000 lekë ose 30.5 % e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 0.63 km ose 36.7 % e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara:

- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4+ shtesë punimesh, Loti 5+ shtesë punimesh, Loti 6+ shtesë punimesh; Loti 7 dhe Loti 8.

Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi

Për tipin e rrugës C2 janë planifikuar fonde në vlerën 665,748,000 lekë ose 13.2 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 4.09 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 426,135,000 lekë ose 64 e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 2.57 km ose 62.8% e sasisë së planifikuar.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1, shtesë punimesh;
- Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë);
- Ndërtim rruga Palas – Dhërmi;
- Rikonstruksion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë;
- Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;
- Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin rrugor Kuben – Vasije;
- Stabilizim i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot - Rrëshen, rruga e vjetër;
- Ndërtim tombino dhe kanali në aksin rrugor Tiranë - Elbasan (aksi i vjetër) dhe ndërtim tombino në aksin rrugor Uzina traktori - Lanabregas.

Ndërtim rruge A e modifikuar

Ky tip rruge përfaqëson një aks rrugor autostradë me katër vija kalimi 4 x 3.75 dhe me dy bankina të asfaltuara me gjerësi 2 x 3 m si dhe dy bankina të paasfaltuara me gjerësi 2 x 1.5 m, së bashku dhe me trafik ndarësen e mesit (NewJersey) gjerësia e trupit të rrugës është 28 m.

Për tipin e rrugës A e modifikuar janë planifikuar fonde në vlerën 120,000,000 lekë ose 2.4 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 0.53 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A e modifikuar është në vlerën 120,000,000 lekë ose 100% buxhetit të planifikuar për këtë zë. Ky zë është realizuar në sasin 0.53 km ose 100% e sasisë së planifikuar.

Konkretisht objekti:

- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3.

➤ **Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 217,700,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore) dhe në sasi 46.1 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 67,698,000 lekë ose 31 % ndaj planit vjetor dhe në km janë realizuar 46.1 km.

Përfshihen objektet:

- 1- Punime ndërtimi për eleminimin e pikave të zeza në rrugë (bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore);
- 2- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior Loti 3, vazhdimi;
- 3- Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar;
- 4- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Verior;
- 5- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qëndror;
- 6- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Jugor.

➤ **Ura dhe Emergjencia**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 326,276,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit ndërtim urash) dhe në sasi 0.25 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 0 lekë. Në këtë zë janë përfshirë dhe fondet e akorduara për ARRSH-në nga fondi i rindërtimit në vlerën 151,539,896 lekë për rindërtimin Urës së Tapizës të dëmtuar nga tërmeti.

Përfshihen objektet:

- Rindërtim i Urës së Tapizës;
- Ndërtim i Urës së Zemblakut;
- Emergjence Rrëshqitja e Borshit;
- Rikonstruksion i Urës së Leklit;
- Rikonstruksion i Urës së Vorës;
- Emergjence Rikonstruksion i Urës së Kirit;
- Emergjencë mbrojtje lumore Ura e Drojës;
- Supervizion punimesh Ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së

Grupi i shpenzimeve për Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, të tjera i detajuar paraqiten si më poshtë:

	<u>PLANIFIKUAR</u>	<u>FINANCUAR</u>
- Vendime gjyqësore	40,000,000 lekë	40,000,000 lekë ose 100% e buxhetit
- Shpronësime	289,035,000 lekë	191,197,879 lekë ose 66% e buxhetit

- Rikonstrukcion i godinës së ARRSH-së dhe tre Drejtorive Rajonale
19,450,000 lekë 4,452,200 lekë ose 23% e buxhetit
- Shpenzimet kapitale për TVSH dhe Kosto Lokale janë planifikuar fonde në vlerën 2,577,000,000 lekë ose 32% e buxhetit dhe janë financuar për 4 mujorin e parë të vitit 2021 si më poshtë:
 - Kosto Lokale 753,500,000 lekë 121,536,876 lekë ose 16 % e buxhetit
 - TVSH e T.D 1,823,500,000 lekë 337,043,595 lekë ose 18 % e buxhetit

Shpenzimet Kapitale me financim të huaj

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2021, buxheti i financimit të huaj është në vlerën 6,856,672,000 lekë dhe është financuar në vlerën 1,879,138,000 lekë ose 27.4 % e planit. Në buxhetin e vitit 2021 janë parashikuar fonde buxhetore për financimin e të gjithë objekteve në vazhdim.

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C dhe Kategoritë të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 1,357 km dhe janë realizuar 1,343 km.

Më poshtë po rendisim komentet tona mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për 4 mujorin e parë të vitit 2021, konkretisht:

	<u>PLANIFIKUAR</u>	<u>FINANCUAR</u>
B -	12 km	7 km ose 58 % e planit.

Ndërtim Rruge Tip C

	<u>PLANIFIKUAR</u>	<u>FINANCUAR</u>
C -	12 km	3 km ose 25 % e planit.

Ndërtim Rruge Tip Kategoritë të ndryshme

	<u>PLANIFIKUAR</u>	<u>FINANCUAR</u>
-	1333 km	1333 km ose 100 % e planit

Kontratat për Studim Projektim për projektet: Projekti i rruges By Pass Elbasan, Dublini i rrugës Milot-Lezhë-Shkodër, rruga Vaqarr - Kavajë dhe Studim i fizibilitetit të autostradës Adriatiko – Joniane, me parashikim total me vlerë prej 259,000,000 lekë, ndiqet nga MIE dhe financimi i tyre realizohet nga MIE.

Programi “TRANSPORTI DETAR”

Shpenzimet Korrente

Plani i buxhetor i shpenzimeve korrente për vitin 2021, është në vlerën 105,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 27,956,000 lekë ose 27%. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2021, në zërin e shpenzimeve korrente janë realizuar fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Investimet me financim të brendshëm, janë planifikuar në shumën 50,000,000 lekë për vitin 2021 dhe realizimi financiar për 4-mujorin e parë të vitit 2021 është në vlerën 35,501,598 lekë ose 71%.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Konservimi i ndërmarrjes së kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve ujore Vau i Dejës” është planifikuar në vlerën 3 milion lekë dhe është realizuar për periudhën 4-mujore në masën 35%, duke qenë se me fondet buxhetore paguhen paga dhe sigurime për punonjësit e kësaj ndërmarrje.
- “Blerje kompjutera, printera, fotokopje për DPD dhe Kapiteneritë” është planifikuar në vlerën 7.6 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar për periudhën 4-mujore pasi kontrata për këtë projekt sapo është lidhur dhe projekti është në proces realizimi.
- “Blerje pajisje navigacionale për Kapiteneritë Durrës, Vlorë, Shëngjin, Sarandë” është planifikuar në vlerën 875 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën 4-mujore është në masën 67% dhe projekti është në proces realizimi.
- “Rikonstruksion i godinës së DPD” është planifikuar në vlerën 27 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën 4-mujore është në masën 100%.
- “Rikonstruksion i kalatës së RORO” është planifikuar në vlerën 6.2 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën 4-mujore është në masën 100%.
- Kolaudim "Rikostruksion i Godinës së DPD" është planifikuar në vlerën 100 mijë lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces.
- Mbikqyrje punimesh "Rikostruksion i Godines së DPD" është planifikuar në vlerën 680 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën 4-mujore është në masën 99%.
- “TVSH për projektin e Konektivitetit të Adriatikut Jugor” është planifikuar në vlerën 300 mijë lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces realizimi.
- “TVSH për projektin e asistencë-teknike për monitorimin, komunikimi i kontrates sektoriale” është planifikuar në vlerën 200 mijë lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces realizimi.
- “TVSH për vendosjen e sistemit të monitorimit dhe informacionit të anijeve VTMS” është planifikuar në vlerën 200 mijë lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces realizimi.
- “TVSH për projektin e rehabilitimit të kalatës së Portit Vlorë” është planifikuar në vlerën 3.3 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces realizimi.
- Kosto lokale për projektin e Konektivitetit të Adriatikut Jugor” është planifikuar në vlerën 500 mijë lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces realizimi.

Programi “TRANSPORTI HEKURUDHOR”

Për 4 mujorin e parë të vitit 2021, realizimi i produkteve paraqitet:

- Për produktin “Sistem Hekurudhor i Reformuar” përfshihet subvencioni për mbështetjen e hekurudhës, janë planifikuar 400 milion lekë dhe janë realizuar 50 milion ose 8%.

- Për produktin “Inspektime të kryera në linjat dhe mjetet hekurudhore” janë planifikuar 23.7 milion lekë dhe janë realizuar 1.333 milion lekë.
- Për produktin “Përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore” janë planifikuar në vlerën 125 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar.
- Për projektin “Blerje traversa druri” janë planifikuar në vlerën 40 milion lekë. Për këtë projekt është hapur tenderi dhe është në fazën e vlerësimit të ofertave.
- Për projektin “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet - Kavajë” janë planifikuar në vlerën 12 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar.
- Për projektin “Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë” janë planifikuar në vlerën 12 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi për këtë projekt është parashikuar të hapet tenderi në dt. 07/06/2021.
- Për projektin “Rikonstruksion i linjes hekurudhore Milot - Lezhe” janë planifikuar në vlerën 12 milion dhe nuk ka realizim pasi është në proces tenderimi.
- Për projektin “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Budull - Gjormë” janë planifikuar në vlerën 12 milion dhe nuk ka realizim financiar pasi për këtë projekt është parashikuar të hapet tenderi në dt. 08/06/2021.
- Për projektin “Riparim vepra arti” janë planifikuar në vlerën 14 milion dhe është në proces tenderimi.
- Për projektin “Punime për mbrojtjen e linjës” janë planifikuar në vlerën 6 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar pasi për këtë projekt është parashikuar të hapet tenderi në dt. 14/06/2021.
- Për projektin “Blerje traversa betoni” janë planifikuar në vlerën 12 milion lekë. Është hapur tenderi dhe ndodhert në fazë e vlerësimit të ofertave.

Për produktin “Rritja e disponibilitetit të mjeteve lëvizëse” janë planifikuar në vlerën 37 milion lekë, sipas projekteve:

- Për projektin “Blerje pjesë këmbimi dhe agregatë për lokomotiva dhe vagonë” janë planifikuar në vlerën 12.000.000 lekë. Është në proces përgatitje të fondit limit.
- Për projektin “Rinovim agregat për lokomotiva” janë planifikuar në vlerën 9.000.000 lekë. Është në proces tenderimi.
- Për projektin “Rikonstruksion i magazinave të NJSHML” janë planifikuar në vlerën 10.000.000 lekë. Është hapur tenderi dhe është në fazën e vlerësimit të ofertave.
- Për projektin “Blerje aksesorë hekurudhore” janë planifikuar në vlerën 5.000.000 lekë. Është hapur tenderi dhe është në fazën e vlerësimit të ofertave.

Për produktin “Studime dhe projektme” janë planifikuar në vlerën 1.5 miliard lekë dhe janë realizuar 6.763.649 lekë.

- Nga këto ka patur realizim financiar në vlerën 3.120.875 lekë për pagesen e “TVSH-së të objektit Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore “Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi)”
- Nga këto ka patur realizim financiar në vlerën 3.641.774 lekë për pagesen e “TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë”

Programi “TRANSPORTI AJROR”

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Në këtë program buxhetor janë përfshirë gjithashtu investime të nevojshme për Aparatin e Ministrisë dhe Organin Kombëtar të Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore (OKIAA).

Shpenzimet korrente

Sipas klasifikimit ekonomik realizimi rezulton:

në mijë lekë

	Plan i Rishikuar Viti 2021	Plani i Periudhës/progresive	Katër mujori i parë 2021
Paga	9,000	3,000	2,133
Sigurime Shoqërore	1,560	520	352
Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,740	2,580	34
Shpenzime Korrente	18,300	6,100	2,520

Shpenzimet kapitale

	<i>Plani</i>	<i>Fakti</i>	<i>% e realizimit</i>
• Financim i brendshëm	122,000	23,387	20%

në mijë lekë

	Plan i viti 2021	Katër mujori i parë i 2021
Blerje e paisjeve dhe instrumentave pune + mobilim zyre OKIAA	1,000	0
Shërbimet inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit	121,000	23,387
Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	122,000	23,387

Zbatimi i projekteve për 4 mujorin e parë të vitit 2021:

- Blerje e paisjeve dhe instrumentave pune + mobilim zyre OKIAA, nuk janë kryer procedurat e prokurimit.

- “Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit, janë realizuar 23,387,000 lekë dhe vazhdon procesi i likuidimit sipas parashikimeve të kontratës.

Programi “FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME“

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës së Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Shpenzimet korrente

Sipas klasifikimit ekonomik realizimi rezulton:

- Paga, Plani vjetor i vitit 2021 është 50,000 mijë lekë. Realizimi për periudhën raportuese është në vlerën 15,233 mijë lekë ose 30.4 % e planit të akorduar.
- Sigurime shoqërore, Plani vjetor 2021 është 8,500 mijë lekë. Për vitin periudhën raportuese realizimi faktik është 2,485 mijë lekë ose 29.2 % e planit të akorduar.
- Mallra dhe Shërbime të tjera, Plani vjetor për vitin 2021 është 31,500 mijë lekë. Për periudhën raportuese, realizimi faktik është 1,170 mijë lekë ose 3.7 % e planit të akorduar.
- Subvencione (për ndërmarrjet/sha. ujësjellës kanalizime), për vitin 2021 janë planifikuar 380,000 mijë lekë. Shpërndarja e fondeve për subvencion për ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizimeve për periudhën raportuese nuk është realizuar, kjo për arsye se shpërndarja e subvencionit për ndërmarrjet e ujësjellësave bëhet pasi shihet performanca e tyre pas 6 mujorit të parë të vitit.
- Shpenzime transporti për buxhet, familjar dhe individë, Plani vjetor i rishikuar 2021 është 214 mijë lekë. Për vitin 2021 realizimi faktik është 146 mijë lekë, ose 68 % të planit të akorduar.

Shpenzimet kapitale

- Për artikullin 230 (studime, projektim dhe oponencë teknike) për vitin 2021 janë planifikuar 91,134 mijë lekë dhe si 4 mujor i parë janë realizuar 14,607 lekë, ose 16 % të planit të akorduar
- Për artikullin 231 (investime me financim të brendshëm) ku përfshihet dhe TVSH + KL) për vitin 2021 janë planifikuar 6,416,882 mijë lekë dhe për 4 mujorin e parë janë realizuar 1,521,245 mijë lekë ose në masë e 23.7 % e planit të akorduar.
- Për artikullin 230 (konsulencë financim i huaj) për vitin 2021 janë planifikuar 2,928,700mijë lekë dhe u realizuan 22,746 mijë lekë, ose 3 % e planit të akorduar.
- Për artikullin 231 (investime me financim të huaj) për vitin 2021 janë planifikuar 5,731,495 mijë lekë dhe janë financuar 830,351 mijë lekë ose 14.5 % të planit të akorduar.

Shpenzime kapitale me financim të brendshëm

1. Investimet buxhetore për rezultatin A/I: Ujësjellës i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2021 është në vlerën 3,676,287 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese të 4 mujorit të parë është realizuar financimi në vlerën 754,424 mijë lekë ose në masë e rreth 18.8 % e planit të akorduar.

2. Investimet buxhetore për rezultatin A/II: Rikonstruksion Ujësjiellësi

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2021 është në vlerën 1,344,613 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese për 4 mujorin e parë është realizuar financimi në vlerën 453,219 mijë lekë, ose në masë e 35.2 % e planit të akorduar.

3. Investimet buxhetore për rezultatin A/III: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 688,482 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese për 4 mujorin është realizuar financimi 198,853 mijë lekë, ose në masën e 28.88 % e planit të akorduar.

4. Investimet buxhetore për rezultatin A/IV: Rikonstruksion KUZ

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 66,153 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese si 4 mujor është realizuar financimi 30,000 mijë lekë, ose në masë e 45.35% e planit të akorduar.

5. Investimet buxhetore për rezultatin A/V: I.T.U.P

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 20,200 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese si 4 mujor është realizuar financimi 20,000 mijë lekë, ose në masë e 99 % e planit të akorduar.

6. Investimet buxhetore për rezultatin A/VI: Konsulencë

Për shërbim konsulence sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 91,134 mijë lekë, në përfundim të periudhës raportuese si 4 mujor është realizuar financimi 14,607 mijë lekë, ose në masën e 16.03% e planit të akorduar.

Shpenzime kapitale me financim të brendshëm

1. Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/I: Ujësjiellës I ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 1,731,722 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 443,431 mijë lekë ose 27.64% e planit të akorduara.

2. Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/II: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 1,692,221 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 428,922 mijë lekë ose 25.3% e planit të akorduara.

3. Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/IV: Konsulencë;

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 2,928,700 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 22,746 mijë lekë ose 19 % e planit të akorduara.

Programi “MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE”

Shpenzimet korrente

Buxheti i shpenzimeve korrente është 600,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 512,855,000 lekë ose 86% e realizuar, ku nga Bashkia Tiranë është financuar projekti koncesionar "Ndërtim i Inceneratorit të Tiranës"

Shpenzimet kapitale

Buxheti i investimeve kapitale me financim të brendshëm është 2,064,272 lekë dhe realizimi financiar është 905,715,000 lekë, ose 44% e realizuar.

Për këtë periudhë ka vazhduar financimi i projekteve koncesionare dhe financimi i projekteve me kontrata të lidhura, si më poshtë:

- "Ndërtim Inceneratori i Fierit"
- "Ndërtim Inceneratori i Elbasanit"
- "Mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta Eko Park Durrës"
- "Ndërtim i venddepozimit Bushat, faza II"
- "Punime shpeshë të impiantit të trajtimit të ujrave dhe shtresave të landfillit Bajkaj"

Gjithashtu janë mbështetur me fonde buxhetore rimbursimi i Tvsh për projektet me financim të huaj nga donatorët, si dhe me kërkesë të Bashkisë Vlorë MIE mori masat dhe bëri të mundur planifikimin në buxhet të fondit prej 24,100,000 lekë për likuidimin e pronarëve të prekur nga projekti "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun Vlorë".

Buxheti i investimeve kapitale me financim të huaj është 1,050,000,000 lekë dhe realizimi financiar 89,876,000 lekë ose 8,5% e realizuar, ku financim ka pasur vetëm në projektin "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun Vlorë" me fondet e disbursuara nga kredia dhe granti.

Projektet e planifikuara në buxhetin e vitit 2021 me financim të huaj:

- "Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, masa shoqëruese (Faza e II)"
- "Sistemi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit"
- "Projekti për mbështetjen e zbatimit të Masterplanit të Mbetjeve të Ngurta"
- "Projekti në fushën e mbetjeve të ngurta financuar në kuadrin e Ekonomisë Cirkulare"
- "Studim Fizibiliteti për zonat funksionale të Mbetjeve Elbasan dhe Fier"

Programi “MBËSHTETJE PËR ENERGJINË”

Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si AKBN, Agjencia e Energjive Bërthamore, Agjencia e Eficencës së Energjisë dhe projekte që menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në mbështetje të politikave për fushën e energjisë, si atë elektroenergjitike, energjisë së

rinovueshme dhe eficences, pagesat e TVSH-ve dhe Kostove Lokale për projektet me financim të huaj, bazuar në marrëveshjet përkatëse.

Duke qenë se sektori energjetik është konsideruar si një sektor i një rëndësie të veçantë, janë alokuar nga buxheti fonde për kryerjen në kohë të studimeve dhe oponentave të nevojshme në sektorin energjistik si dhe për krijimin e kushteve të favorshme me synim orientimin e profesionistëve dhe bizneseve drejt zbatimit të politikave për eficiencën e energjisë në Shqipëri.

Realizimi i objektivave buxhetore të programit janë planifikuar 34 produkte, një pjesë e të cilave është realizuar plotësisht dhe 11 produkte janë realizuar pjesërisht, si më poshtë vijon:

- ❖ Produkti *“Monitorime në sektorin Energjistik”*, ka në përbërjen e tij 2 nënprodukte:
 - Kontrolli i realizimit të investimeve për ndërtimin e HEC-ve me konçension sipas kontratave përkatëse dhe marrja në dorëzim e tyre, sipas programit të zhvillimit të projekteve të vlerësuar nga Oponenca Teknike - Raporte për Oponencën Teknike, është realizuar në masën 28%.
 - Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së - Bilanc Energjetik, është realizuar në masën 32%.
- ❖ Produkti *“Studime për përmirësimin e sektorit energjistik, përmirësimin e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme”* ka në përbërjen e tij 14 nënprodukte (studime) të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit 2021 nga të cilat është realizuar plotësisht 1 prej tyre dhe pjesërisht 6 prej tyre si më poshtë vijon:
 - Projekt ide, studim fisibiliteti dhe projekt zbatimi i sistemit të ngrohjes së Korçës duke përfshirë lenden drusore (projekt i ri), është realizuar në masën 100%.
 - Studimi i plotë i fisibilitetit për vendosjen e Kullave të Karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë, është realizuar në masën 60%.
 - Studimi për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të burimeve energjetike hidrokarbure në sektorin e transportit referuar zhvillimeve teknologjike (është Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure), është realizuar në masën 32%.
 - Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure, është realizuar në masën 32%.
 - Studim për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të burimeve energjetike hidrokarbure në transport referuar zhvillimeve teknologjike në këtë fushë, është realizuar në masën 32%.
 - Studim mbi ndikimin në mjedis nga aktiviteti në sektorin hidrokarbur, përkatësisht me kodin M064054 është realizuar në masën 32%.
 - Rregullore për Verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, normat teknike dhe procedurat për prodhimin dhe përzierjen e biokarburantet, është realizuar në masën 32%.

- ❖ Produkti “*TVSH + Kosto Lokale për projektet në fushën e energjisë*”, ka në përbërjen e tij 12 nënprodukte nga të cilat gjatë vitit 2021 janë realizuar pjesërisht 3 prej tyre, si më poshtë:
 - TVSH për projektin "Rimëkëmbje e sektorit Energjetik", është realizuar në masën 20%.
 - Kosto Lokale për projektin "Rimëkëmbje e sektorit Energjetik", është realizuar në masën 12%.
 - TVSH Projekti ENERJ bëhet TVSH për projektet GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC dhe Re-Source, është realizuar në masën 2%.

- ❖ Produkti “*Ndërtim/Rikonstruksion*”, ka në përbërjen e tij 6 nënprodukte nga të cilat gjatë vitit 2021 janë në proces realizimi produktet si më poshtë:
 - Projekt Pilot për përmirësimin e Eficences së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.
 - Projekt Pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e furnizimit me ujë.
 - Projekt Pilot për ndërtimin e një godine me “0 Energji”.
 - Supervizion i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë.
 - Vendosija e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2km Smart City - rruga e Energjisë Pastër".
 - Projekt pilot për sistemin e ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2km Smart City - rruga e Energjisë Paster".

Programi “MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE”

Për katërmujorin e parë të vitit 2021, objektivat e këtij programi buxhetor janë realizuar në :

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rreziqeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.
- Shfrytëzimi me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Shpenzimet korrente

Plani i miratuar për vitin 2021, për shpenzimet korrente të programit është 157,650,000 lekë, kurse realizimi financiar është 44,005,000 lekë, ose 28% e planit e realizuar, ku këtu përfshihet si njësi shpenzuese Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe fondet e vitit 2021, janë realizuar si më poshtë:

- Fondi për pagat e punonjesve planifikuar 118,215,000 lekë dhe realizimi financiar është 32,993,000 lekë, ose 28 % e planit e realizuar.
- Fondi për sigurime shoqërore, planifikuar 19,740,000 lekë dhe realizimi financiar është 5,463,000 lekë, ose 28% planit e realizuar.
- Fondi për shpenzimet operative, planifikuar 18,045,000 lekë dhe realizimi financiar është 5,290,000 lekë, ose 30 % e planit e realizuar.
- Fondi për transfertat korrente të huaja, plani 1,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 0 lekë.
- Fondi për transfertat buxhetore për familje e individë, planifikuar 650,000 lekë dhe realizimi financiar 259,000 lekë, ose 39 % e planit e realizuar.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Në projektet me financim i brendshëm, janë përfshirë projekte studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit mineral, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike. Këto projekte janë implementuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, dhe ndërmarrjet në konservim Albbakër sh.a, Albkrom sh.a, Albminierat sh.a.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit vjetor të rishikuar, janë në vlerën 125,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 32,085,000 lekë, ose 26% e planit e realizuar.

Objektivat e këtij programi realizohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila për vitin 2021, ka në procedurë realizimin e 7 projekteve studimore, në vlerën 31,420,000 lekë dhe realizim financiar 14,640,000 lekë ose 47 % e planit e realizuar, në projektet si më poshtë :

- Projekti "Përditësim gjeohapsinor i të dhënave të lejeve minerare"
- Projekti "Azhornimi gjeohapsinor i hapësirave që krijohen nga shfrytëzimi mineral nëntokësor"
- Projekti "Mbikqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare metalore dhe jometallore"
- Projekti "Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimet teknologjike e mjedisore"
- Projekti "Studim mbi zonimin mineral dhe hartimi i planit vjetor dhe 3-vjecar mineral"
- Projekti "Raport vjetor mbi gjëndjen mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji"
- Projekti "Monitorimi i fenomeneve të postshfrytëzimit në minierat e mbyllura"

Për ndërmarrjet në likuidim "Abminiera", "Albkrom", "Albbakër" sh.a, plani i buxhetit për vitin 2021, është 24,900,000 lekë dhe realizimi financiar është 13,900,000 lekë ose 56% e planit e realizuar dhe janë likuiduar detyrime të prapambetura për pagat, sigurimet shoqërore të punonjësve, detyrime tatimore dhe ndaj të tretëve, si më poshtë:

- Shoqëria Albminera, plani 10,000,000 lekë dhe realizimi financiar 5,000,000 lekë;
- Shoqëria Albakër, plani 5,000,000 lekë dhe realizimi financiar 3,000,000 lekë;
- Shoqëria Albkrom, fonde 9,900,000 lekë dhe realizimi 5,900,000 lekë.

Për Sekretariatit Teknik Shtetëror, çdo vit planifikohen fonde buxhetore për projektin "Raport mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri", plani 15,000,000 leke dhe realizimi financiar 3,544,000 lekë ose 24% e planit e realizuar.

Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, janë planifikuar fonde në vlerën 40 milion lekë, për dy projekte, ku një projekt në vlerën 20,000,000 lekë, aktualisht rezulton të jetë fondi i ngrirë i miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Aktualisht, projekti tjetër "Aparatura e paisje teknologjike pune e paisje pune profesionale për nevoja të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", në vlerën 20,000,000 lekë është në fazën e procedurave të prokurimit.

Programi “MBËSHTETJE PËR INDUSTRIJË”

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për zhvillimin e industrisë.

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial, Repartit Inspektim Shpëtim Miniera dhe Qendrës së Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Shpenzimet korrente

Fondet e alokuara për këtë program buxhetor të shpenzimeve totale të miratuara për MIE për vitin 2021 janë 376,616 mijë lekë. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se gjatë të vitit 2021 shpenzimet për këtë program janë realizuar në masën 95 %.

Sipas klasifikimit ekonomik realizimi rezulton:

000 lekë

	Plani i Rishikuar 2021	Realizimi i 4/mujorit 2021	Realizimi në % Plan/fakt 4/mujori
Shpenzime Korrente	321,854	104,858	
1.1.Paga	220,950	77,629	35%
1.2. Sigurime	44,600	13,016	29%
1.3.Operative	55,450	14,120	25%
Transferta	854	93	11%

Shpenzimet kapitale

Analizuar realizim i investimeve sipas produkteve paraqitet si me poshtë:

- Produkti 1 “Blerje automjeti për inspektim dhe emergjenca”, fondi i parashikuar 6000 mijë lekë është prokuruar nga Ministria e Brendshme dhe është në proces lidhja e kontratës.
- Produkti 2 ”Blerje paisje dhe aparatura për grupin e shpëtim inspektimit”, fondi i planifikuar 2000 mijë lekë dhe është në procesin e prokurimit.

- Produkti 3 “Blerje paisje zyre”, fondi i planifikuar 120 mijë lekë është në proces tenderimi.
- Produkti 4 “Blerje paisje kompjuterike dhe sigurim me kamera”, fondi i planifikuar 1380 mijë lekë, janë kryer likujdimet në shumën 895 mijë lekë si detyrime për vlerat e faturave nga viti kaluar, pjesa tjetër do të tenderohet.
- Produkti 5 “Hartim i projektit te zonave industriale”, fondi i planifikuar 1000 mijë lekë dhe është në proces tenderimi.
- Produkti 6 “Buletin Informativ për Industrinë”, fondi i planifikuar 700 mijë lekë, nuk do realizohet pasi nuk është siguruar bashkëpunim me Universitetin.
- Produkti 7 “Studim në fushën e Industrisë”, fondi i planifikuar 2500 mijë lekë, nuk do të realizohet pasi ka mungesë stafi për Ing. kimist në QGTKRR.
- Produkti 8 “Blerje paisje dedegtuse dhe monitorim gazrash”, fondi i planifikuar 500 mijë lekë është në proces tenderimi.
- Produkti 9 “Ndertim riparim i gardhit rrethues”, fondi i planifikuar 1500 mijë lekë është në proces tenderimi.
- Produkti 10 “Blerje mjet transporti për kimikate”, fondi i planifikuar 2888 mijë lekë është në proces tenderimi.
- Produkti 11 “Hapje pusi për furnizim me ujë ”, fondi i planifikuar 594 mijë lekë dhe janë realizuar 90% e volimit të punimeve.
- Produkti 12 “Blerje paisje profesionale pune”, fondi i planifikuar 1000 mijë lekë dhe është në proces tenderimi.
- Produkti 13 “Blerje laboratorike për treguesit cilësorë të naftës dhe gazit”, fondi i planifikuar 15300 mijë lekë janë duke u përpiluar specififikimet teknike.
- Produkti 14 “Aparatura per laboratorin e tekstilet”, fondi i planifikuar 13500 mijë lekë, janë duke u përpiluar specififikimet teknike.
- Produkti 15 “Konservim Azotiku Fier”, me fondin e planifikuar prej 8000 mijë lekë kryhen likujdimet për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit. Deri në fund të 4 mujorit të parë janë likujduar 1867 mijë lekë.
- Produkti 16 “Monitorim landfilli”, fondi i planifikuar 1000 mijë lekë është në proces likujdimi për dy landfillet.
- Produkti 17 “Konservim Kombinati Energjitik Elbasan”, fondi i planifiikuar 8000 mijë lekë janë likujduar 8000 mijë lekë për fatura të prapambetura nga viti kaluar si dhe paga dhe sigurime shoqërore.
- Produkti 15 “Konservim Prodhim Çeliku Elbasan”, fondi i planifikuar 19000 mijë lekë, janë likujduar paga dhe sigurime shoqërore në vlerën 8200 mijë lekë.

Programi “MBËSHTETJE PËR RRJETET E KOMUNIKACIONIT”

Në programin “Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit”, nuk janë parashikuar investime me financim të brendshëm në PBA për vitin 2021 dhe për këtë arsye është bërë një kërkesë për fonde shtesë me financim të brendshëm dhe të huaj.

Projektet e parashikuara për vitin 2021:

- Zhvillimi Rajonal i Broadband"-Asistencë teknike "- Projekti pilot 1 - për zonën e veriut – Projekti nuk ka filluar akoma, pritet miratimi i TORs.

- Zhvillimi Rajonal i Broadband-"Asistence teknike "Projekti i Atlasit të broadband – Projekti nuk ka filluar akoma, këtë muaj janë miratuar TORs dhe pritet të caktohen konsulentët për fillimin e projektit.

Programi “PLANIFIKIMI URBAN”

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Arkivit Qëndror Teknik të Ndërtimit, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Shpenzimet korrente

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi faktik paraqitet:

	<i>000lekë</i>
- Shpenzimet për paga	5 224
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore	858
- Mallra dhe shpenzime të tjera	1 752
- Transferta për buxhetin familjar dhe individual	34

Shpenzimet kapitale

Investimet me financim të brendshëm

Për programin “Planifikim Urban” janë parashikuar, në total 104 milion lekë, 7 milionë për AQTN-në, dhe rreth 97 milionë për projektet që ndjek Aparati i MIE.

Zbatimi i projekteve për 4 mujorin e parë të vitit 2021:

- Projekti “Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore”, për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar. Projekti ka përfunduar në 2019 afati i hartimit sipas kontratave, janë faturat për likuidim në sektorin e finances.
- Projekti “Pajisje informatike”, për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces miratimi nga AKSHI.
- Projekti “Pajisje mobilje zyre”, për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar pasi projekti është në proces lidhje kontrate.
- Projekti “Projekte pilote për rikualifikimin e blloqeve urbane”, për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar pasi pritet këkesa nga bashkitë për projekte të tilla.
- Projekti “Hartimi i udhëzimeve për zbatimin e eurokodeve, për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar pasi pritet përcaktimi i vlerës nga Universiteti Politeknik i Tiranës.
- Projekti “Sistemi i integruar për informatizimin e Manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar pasi është në procedurë prokurimi nga AKSHI.
- Projekti “Hartimi i Standarteve të projektimit të spitaleve dhe klinikave mjeksore” për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar. Ky projekt nuk do të realizohet për shkak të mospërkthimit në kohë të standarteve.
- Projektin “Hartimi i Planeve sektoriale/rajonale me tematika të veçanta” për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka realizim financiar. Me nismën e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Sektoriale, projekti do të vazhdojë dhe në vitin 2022.

Investimet me financim të huaj

Investimet me financim të huaj, për vitin 2021 jnaë planifikuar 220 milionë lekë për projektin “Projekti i GIZ, Lëvizja urbane miqësore ndaj mjedisit në Bashkinë Tiranë”. Sqarojmë në mënyrë të përsëritur se ky investim i përket Bashkisë Tiranë.